



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 711 Prot.

Tiranë, më 03 / 05 / 2019

V E N D I M

Nr. 13 datë 03 .05 . 2019

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE JASHTË ORARIT TË PUNONJËSVE TË
SEKRETARIVE MËSIMORE”.**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 18, datë 21.05.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë”, për vitin akademik 2018-2019, të ndryshuar, Vendimin Nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, me propozim të Administratorit me shkresë nr. 24/9 Prot., datë 27.02.2019 , Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e orëve jashtë orarit zyrtar dhe në ditë pushimi të punonjësve të sekretarive mësimore sipas, tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Administratori i Institucionit si dhe njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Alba Thoma

Arjan Beqiraj

Irida Vejsiu

Jonida Teta

Kryetar

Arben DHIMA